



REPUBLIKA E ITALISË
KOMUNA QUINTO DI TREVISO



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KLINËS

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI- BINJAKËZIMIT

ndërmjet

Komunës së Klinës në Republikën e Kosovës

dhe

Komunës Quinto Di Terviso në Republikën e Italisë

për bashkëpunim në fushën e

Kompetencave vetanake

Duke konsideruar të nevojshëm bashkëpunimin në fushën e ofrimit të shërbimeve në shëndetësi, kulturë, arsim, sportit, ekonomi dhe turizm.

Duke pranuar, që pjesëmarrja në një aktivitet të tilla është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim dy palësh mbi baza të drejta.

Duke ju referuar, Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, neni 17 pika (k) dhe 30, Ligji Nr.04/L-010, për Bashkëpunimin Ndërkomunal, Ligji Nr. 02/L-75, për Arbitrazhin, dhe Rregullores së MAPL-së për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtarë.

Kemi rënë dakord mbi arritjen e kësaj marrëveshje bashkëpunimi të mëposhtme:

Neni 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Marrëveshje bashkëpunimi- binjakëzimit është; *Se ne duam ta thellojmë, zgjerojmë dhe forcojmë miqësinë, mirëkuptimin dhe të kuptuarit mes nesh , në bazë të një "Miqësie Evropiane", baza e secilës është një mirëkuptim i bazuar në paqe, unitet, barazi tolerancë dhe demokraci.*

1. Do të punojmë për zhvillimin e përparimin e shtetit tonë, unitetin, demokracinë, barazinë dhe paqen në Evropë .
1. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm .

Neni 2

FORMAT E BASHKËPUNIMIT (APO FUSHAT E BASHKËPUNIMIT)

1. Shkëmbimi i përvojave duke marrë pjesë direkt, në festat kulturore, në panairot e ndryshme, në turne të ndryshme sportive dhe në turizëm.
2. Secila Komunë merr për obligim akomodimin e mysafirëve kurdoherë që ata vinë me ftes të Kryetarit të Komunës.

Neni 3

1. Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Klinës Republika e Kosovës .
 - 1.1. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e shëndetësisë,
 - 1.2. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e arsimit ,
 - 1.3. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit,
 - 1.4. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e zhvillimit ekonomik.
2. Të drejtat dhe detyrimet e Komunës Quinto Di Trevesio, Republika e Italisë
 - 2.1. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e shëndetësisë,
 - 2.2. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e arsimit,
 - 2.3. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit,
 - 2.4. Shkëmbimi i përvojave në sektorin e zhvillimit ekonomik.

Neni 4

KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për të formuar një grup të përbashkët, i cili është përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes në fjalë .

Neni 5

DETYRIME TJERA

1. Palët marrin masat e nevojshme për të realizuar veprimtaritë në të gjitha fazat e ndërtimit nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshje dhe nënshkrimit të akteve tjera të mëvonshme që dalin nga ky bashkëpunim reciprok e që kanë të bëjnë me kompetencat vetanake të komunave.
2. Palët me akt te veçantë caktojnë një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit të përcaktuar me këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 6

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Kjo marrëveshje do të vazhdojë në kohë të pacaktuar.
2. Kjo marrëveshje mund të plotësohet dhe ndryshohet me pajtim të palëve përmes komunikimit të shkruar. Amandamenti do jetë pjesë integrale e marrëveshjes pas nënshkrimit.
3. Çdo mosmarrëveshje e krijuar mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore, me mirëkuptim, me negociata dhe nëse është e nevojshme me anë të ndërmjetësimit ose arbitrazhit.
4. Kjo marrëveshje është hartuar në 4 kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga 2 kopje.
5. Kjo marrëveshje hynë në fuqi sipas procedurave të parapara ligjore.

Kryetari i Komunës së Quinto Di Treviso

Ivano Durigon

Kryetari i Komunës

Zenun Elezaj